

GJYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS

P 408/11

11 Maj 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Jonathan Welford Carroll, Kryetar i Trupit Gjykues, si dhe Gjyqtarja e Kosovës, Mejreme Memaj, dhe Gjyqtari i EULEX-it, Andrew Hatton, anëtarë të Trupit Gjykues,

Në çështjen penale kundër:

(1) **ZK**, i lindur më ***** në fshatin ***** , Komuna e ***** , ku aktualisht banon, serb i Kosovës,

I akuzuar sipas Aktakuzës së parashtruar më datë 1 Gusht 2011 dhe të konfirmuar më 23 Gusht 2011, të ngritur nga Prokurori i PSRK-së, z. Suad Kuraja, për vepra penale si në vijim që ndiqen penalisht sipas *ex-officio*:

1. **Krime të Luftës kundër popullatës civile**, që parashihet dhe ndëshkohet me **nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale Socialiste të Republikës së Jugosllavisë (KPRFSJ-së)**, aktualisht të penalizuar me nenet 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), për shkak të shkeljes së **Nenit 3 të Përbashkët** të katër Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949 (neni i përbashkët 3), si dhe **Neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit II të 8 Qershorit 1977**, Plotësime të Konventave të Gjenevës të 1949 (APII), të gjitha rregullave ndërkombëtare të ligjeve në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe të gjitha kohëve relevante për aktvendimin aktual, **i pandehuri**, nga data 24 Maj 1999 në cilësinë e gardianit të burgut në Lipjan, **ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore**, duke shkaktuar vuajtje të madhe dhe duke shkelur integritetin trupor ose shëndetin me rrahje dhe goditje me shkop gome, shqelma dhe grushta të burgosurin GM të mbajtur në burgun e Lipjanit, deri në alivanosje dhe më pas viktima vdiq më 25 Maj 1999

Në burgun e Lipjanit, më 24 Maj 1999.

2. **Krime të Luftës kundër popullatës civile**, që parashihet dhe ndëshkohet me **nenet 22 dhe 142 të KPRFSJ-së**, aktualisht të penalizuar me nenet 23 dhe 120 të KPK-së, për shkak të shkeljes së **Nenit 3 të Përbashkët KGj** si dhe **Neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit II**, të gjitha rregullave ndërkombëtare të ligjeve në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe të gjitha periudhave kohore relevante për aktvendimin aktual, **i pandehuri**, në cilësinë e gardianit të burgut në Lipjan, **ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore** (duke shkaktuar vuajtje të madhe dhe duke shkelur integritetin trupor ose

shëndetin me rrahje dhe goditje me shkop gome, shqelma dhe grushta) të burgosurin JR të mbajtur në burgun e Lipjanit,

Në burgun e Lipjanit, më 24 Maj 1999

3. **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve të paraparë dhe të ndëshkueshëm me Nenin 328 paragrafi 2 i KPK-së**, sepse ky i pandehur duke filluar nga viti 1999 dhe deri më 7 Prill 2011, në shtëpinë e tij në fshatin Dobrotin, nr. 97, Komuna e Lipjanit, ka mbajtur në posedim, pa leje të vlefshme, armën si në vijim: një “Zastava” revolver të tipit TT, të kalibrit 7.62, me numrin serik 1878, dy karikatorë të revolverit të njëjtë dhe 37 plumba të kalibrit 7.62 – të gjitha funksionale,

Në fshatin Dobrotin, më 7 Prill 2011

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor më 1, 2, 3, 17 Nëntor 2011, 2 dhe 6 Dhjetor 2011, 11 Janar 2012, 29 dhe 30 Mars 2012, si dhe më datë 8 Maj 2012, në prani të publikut, si dhe në prani të pandehurit, Avokatit të tij Mbrojtës, Prokurorit të PSRK-së,

Pas pleqnimit dhe votimit të mbajtur më datë 8 Maj 2012

Në pajtim me Nenin 391 të KPPK-së, shpalli këtë

AKTGJYKIM

1. **I pandehuri ZK, i identifikuar si më lartë, shpallet fajtor lidhur me Pikën Një të aktakuzës**

Sepse më datë ose rreth datës 24 Maj 1999, pasi që të burgosurit janë transportuar nga Burgu i Dubravës për në Burgun e Lipjanit, GM së bashku me një numër të pacaktuar të burgosurve tjerë shqiptarë janë detyruar të kalojnë përgjatë dy rreshtave të gardianëve të burgut, policëve dhe paramilitarëve serb dhe janë trajtuar në mënyrë çnjerëzore me ç ‘rast është shkelur integriteti trupor me rrahje nga ana e të Pandehurit dhe të tjerëve me armë, grushta dhe shqelma dhe në këtë mënyrë kanë pësuar lëndime nga të cilat M vdiq në një çast në mes të rrahjes dhe datës 25 Maj 1999.

Duke vepruar kësisoj, i Akuzuari ZK ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimit të Luftës Kundër Popullatës Civile siç përshkruhet më lartë

- 2. I pandehuri ZK, i identifikuar si më lartë, shpallet fajtor lidhur me Pikën Dy të Aktakuzës**

Sepse më datë 24 Maj 1999, pasi që të burgosurit janë transportuar nga Burgu i Dubravës për në Burgun e Lipjanit, JR së bashku me një numër të pacaktuar të burgosurve të tjerë shqiptarë janë detyruar të kalojnë përgjatë dy rreshtave të gardianëve të burgut, policëve dhe paramilitarëve serb dhe janë trajtuar në mënyrë çnjerëzore me ç ‘rast është shkelur integriteti i tyre trupor me rrahje nga i Pandehuri dhe të tjerëve me armë, grushta dhe shqelma, dhe në këtë mënyrë kanë pësuar lëndime.

Duke vepruar kësisoj, i Akuzuari ZK ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimit të Luftës Kundër Popullatës Civile siç përshkruhet më lartë.

- 3. I pandehuri ZK, i identifikuar si më lartë, shpallet fajtor lidhur me Pikën Tre të aktakuzës**

Sepse më datë 7 Prill 2011, në fshatin *** i Pandehuri ka qenë në posedim të një revoleje të tipit TT Zastava, të kalibrit 7,62 mm, me numrin serik 1878. Dy karikatorë dhe 37 plumba, të gjitha funksionale, pa një leje valide për armë.**

Duke vepruar kësisoj, i Akuzuari ZK ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim të Nenit 328(2).

Dënimi:

- 1. Në pajtim me Nenin 38 dhe Nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, ZK dënohet me 10 vjet burg sa i përket pikës një të aktakuzës;**
- 2. Në pajtim me Nenin 38 dhe Nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, ZK dënohet me 6 vjet burg sa i përket pikës dy të aktakuzës**
- 3. Në pajtim me Nenin 64 dhe 328 të Kodit Penal të Kosovës, ZK dënohet me 500 Euro gjobë sa i përket pikës tre të aktakuzës**

4. Në pajtim me Nenin 48 dhe nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, ZK dënohet me **dënim unik 14 vjet burg dhe 500 Euro gjobë.**
5. Në pajtim me Nenin 50 paragrafin 1 të Kodit Penal të RSFJ-së, koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në kuadër të dënimit të shqiptuar. Në veçanti koha që nga 7 Prilli 2011 deri në çastin kur Aktgjykimi të merr formën e prerë do të hiqet. gjegjësisht zbritet, nga dënimi.

Prandaj paraburgimi caktohet deri në kohën kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Shpenzimet e procedurës

I pandehuri është i detyruar të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 114, 80 Euro

ARSYETIMI

1. Historia procedurale

- 1.1 Ngjarjet e përshkruara në aktakuzë kanë ndodhur në Maj të vitit 1999. Hetimet e ngjarjeve filluan në vitin 2011, kur njëri nga palët e dëmtuara, JR shkoi në polici dhe i raportoi ngjarjet. Nga kjo deklaratë në polici, hetimet filluan. Më 7 Prill 2011, i akuzuari ZK u arrestua dhe iu caktua paraburgimi në procedurën paraprake.
- 1.2 Aktakuza është parashtruar më datë 1 Gusht 2011 dhe u konfirmua nga ana e gjyqtarit të EULEX-it më datë 23 Gusht 2011. Aktakuza fillimisht pretendon sipas Pikës Një (1) se i akuzuari “ka shqelmuar dhe grushtuar GM në pjesë të ndryshëm të trupit, deri në alivanosje dhe më pas vdiq ma datë 25 Maj 1999”.
- 1.3 Gjyqtari i Konfirmimit ruajti faktin e vdekjes së GM në kuadër të përshkrimit faktik të aktakuzës, por pohoi se vdekja nuk mund t’i atribuohet drejtë për drejtë të pandehurit. Kjo për shkak se nuk ekziston lidhje e drejtë për drejtë rasti në mes të veprimeve të të pandehurit dhe vdekjes së GM. Kështu, pika e parë e aktakuzës është konfirmuar me modalitetet se i pandehuri sipas të gjitha gjasave ka kryer veprën penale të trajtimit çnjerëzor duke përdorur dhunën kundër GM.
- 1.4 Sidoqoftë, më datë 26 Tetor 2011, Prokurori i PSRK ka parashtruar në Gjykatë aktakuzën e korigjuar sa i përket Pikës Një (1), kështu që versioni origjinal i aktakuzës, siç u cekë më lartë, është ri-paraqitur. Trupi Gjykues aprovoi këtë rivendosje të pikës Një (1) në bazë të asaj se nuk mund të konkludohet se veprimet e ZK ishin shkakuar i vetëm i vdekjes së GM, lidhje e qartë dhe e dukshme faktike që

ka të bëjë me rrahjen, në të cilën pretendohet se ZK ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe vdekjes së GM mjaftonte të konstatohet se sjellja e ZK ishte faktor kontribues i vdekjes.

1.5 Kryesuesi i Trupit Gjykses ka zhvilluar një Mundësi të Jashtëzakonshme Hetuese më datë 17 Tetor 2011 kur pala e dëmtuar JR është marr në pyetje gjerësisht. Të gjitha palët ishin të pranishme: Prokurori i PSRK-së, i pandehuri dhe avokatët e tij mbrojtës. Pala e dëmtuar është marr në shqyrtim nga ana e Prokurorit Publik, Mbrojtja dhe Gjyqtari Kryesues.

1.6 Shqyrtimi kryesor filloi më datë 1 Nëntor 2011. Trupi gjykses dëgjoi dëshmitarët si në vijim: F. M. , Xh. M., Dr. M. G., A. M., S. B., I. P., R. G. , H. M., M. Th. , I. T., M. Ll., S. B. , E. G., si dhe dëshmitarët e mbrojtjes: M. D., S. M., M. M., S. R., I pandehuri vendosi të dëshmojë gjatë seancës së mbajtur më datë 30 Prill 2012.

1.7 Të gjitha deklaratat që janë dhënë nga dëshmitarët gjatë fazës së hetimeve janë konstatuar si të pranueshme dhe janë përfshi në shkresat e lëndës.

1.8 Trupi gjykses po ashtu pranoi dhe përfshiu në shkresat e lëndës dokumentet si në vijim:

1.8.1 Konfirmimi i identitetit të lëshuar nga Zyra e Personave të Zhdukur dhe të Forensikës më 12 Nëntor 2003;

1.8.2 Çertifikatë e identifikimit, të lëshuar nga UNMIK-u më 10 Janar 2004;

1.8.3 Çertifikatë e vdekjes, të lëshuar nga Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ekzaminimit Mjekësor, të lëshuar më datë 31 Dhjetor 2003

1.8.4 Raporti i autopsisë, të lëshuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, më datë 26 Maj 2000;

1.8.5 Raporti im policisë më ekstraktin e bashkangjitur nga librat e Morgut të vitit 1999, të dorëzuar në Gjykatë nga ana e Prokurorit Publik më 17 janar 2012.

2. Kompetencat e Gjykatës

2.1 Në pajtim me Nenin 23 (1) të KPPK-së, gjykatat e qarkut kanë kompetencë të gjykojnë veprat penale në shkallën e parë që janë të dënueshme me burg së paku 5 vjet ose me burgim afatgjatë.

2.2 Vepra penale e krimit të luftës shënuar në aktakuzë është e dënueshme me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, si dhe vepra penale e mbajtjes në posedim të paligjshëm të armës, siç është definuar në Nenin 328 (2) të KPK-së është e

dënueshme me burgim nga një deri në tetë vjet, kështu që kompetenca materiale mbetet tek gjykata e qarkut.

2.3 Sipas aktakuzës, vepra penale ka ndodhur në Lipjan, e cila është në kuadër të kompetencave territoriale të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Kështu që, në pajtim me Nenin 27 (1) të KPPK-së, Gjykatat e qarkut të Prishtinës ka kompetencë territoriale për të gjykuar këtë çështje.

2.4 Në pajtim me Nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përcaktimin dhe Përzgjedhjen e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, (më tej LmJ), Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurat penale do të kenë juridiksion dhe kompetencë mbi çdo çështje që hetohet dhe ndiqet penalisht nga PSRK-ja.

2.5 Rasti aktual është përfaqësuar nga prokurori i PSRK-së; prandaj, në përputhje me Nenin 4.7 të LmJ-së, trupi gjykues i gjykatës së qarkut përbëhet nga paneli i përzier nga dy Gjyqtarë të EULEX-it dhe një Gjyqtar vendor.

2.6 Asnjëra nga palët nuk ka kundërshtuar përbërjen e trupit gjykues.

3. Gjetjet ligjore dhe faktike

3.1 **JR** ka dhënë deklaratat dhe dëshminë në kuadër të këto procedurave:

3.1.1. Deklaratë e dëshmitarit në PK më 10/12/2009

3.1.2. Deklaratën e dëshmitarit tek Policia e EULEX-it më 24/09/2010

3.1.3. Deklaratë e dëshmitarit në PK më 10/02/2011

3.1.4. Seancë Dëgjimore e Dëshmitarit në praninë e Prokurorit të PSRK-së më datë 24/05/2011

3.1.5. Mundësinë e Jashtëzakonshme Hetuese më 17/10/2011

3.2 JR deklaroi se kishte qenë i mbajtur në arrest në burgun e Lipjanit dy herë. Herën e parë nga Dhjetori 1998 deri në Shkurt 1999. Megjithëse pohoi se është rrahur gjatë kësaj periudhe, rëndësia primare e tregimit të JR lidhur me mbajtjen në arrest herën e parë në Lipjan është se gjatë kësaj periudhe e njohu ZK si njërin nga gardianët e Burgut të Lipjanit¹. Gjykata vë në dukje se edhe pse në deklaratën e tij të parë të shkurtë më datë 10/12/2009, JR nuk i referohet ZK gatë qëndrimit të tij të parë në Burgun e Lipjanit, në deklaratën e tij të dytë më datë 29/09/2010, JR i referohet një gardiani serb të burgut që quhej Z***, rreth 25 vjeç, që ishte i pranishëm gjatë qëndrimit të tij të parë në arrest në Lipjan. I pandehuri e pranon se njihej me nofkën

VËREJTJE: të gjitha referencat për faqet i bëhen dokumenteve në versionin anglisht.

¹ Procesverbal i Mundësisë hetuese të jashtëzakonshme 17 Tetor 2011, faqe 4-5

‘Z***’ nga familja. Më vonë në deklaratën e njëjtë, JR në mënyrë të veçantë deklaroi se ZK ishte njëri nga gardianët në Burgun e Lipjanit që e torturoi. Në deklaratën e njëjtë JR dha përshkrimin e K si në vijim: ‘rreth 23 vjeç, 185 cm i gjatë, sytë ngjyrë kafe, flokë të shkurta ngjyrë kafe, një vragë në anën e majtë të fytyrës’. Megjithëse gjatë kohës së shqyrtimit kryesor ZK ishte 39 vjeç, përshkrimi i dhënë nga JR është mjaft në përputhje me pamjen aktuale të ZK duke përfshirë praninë e vragës në faqen e tij ashtu siç u përshkrua. Në seancën dëgjimore përballë Prokurorit të PSRK më 24 Maj 2011 JR e përsëriti dhe ofroi detaje plotësuese të incidentit që përfshinë ZK gjatë periudhës së qëndrimit të parë në Burgun e Lipjanit. Gjykata vëren në deklaratën e tij se JR deklaroi se nuk njihnte të Pandehurin me emër gjatë periudhës së mbajtjes në arrest herën e parë, këtë e mësoi vetëm pas kthimit të tij në burgun e Lipjanit më datë 24 Maj 1999², një fakt që e përsëriti dhe e sqaroi gjatë marrjes në kundër pyetje nga ana e avokatit mbrojtës.³ Gjatë Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetimore, JR e konfirmoi se gjatë incidentit në burgun e Lipjanit më 24 Maj 1999 mësoi emrin e ZK, megjithëse njohu të pandehurin si gardian nga qëndrimi i JR herën e parë në Burgun e Lipjanit.⁴

3.3 Në një çast, JR e larguan nga Burgu i Lipjanit për në Burgun e Dubravës. Gjatë dhënies së dëshmisë së tij, JR tregoi në detaje ngjarjet brenda Burgut të Lipjanit. Meqë ato ngjarje nuk janë pjesë e aktakuzës në çështjen kundër ZK, ato fakte nuk përsëriten në këtë aktgjykim dhe kjo gjykatë nuk konstaton gjetje të fakteve të veçanta lidhur me ngjarjet në burgun e Dubravës.

3.4 Si rezultat i ngjarjeve të Dubravës, të burgosurit u transferuan në Burgun e Lipjanit më datë 24 Maj 1999. Ekzistonin dy kategori relevante të të burgosurve; të lënduar dhe të pa-lënduar. Të lënduarit u transferuan në Lipjan me maune. Ta pa-lënduarit u transferuan në Lipjan me autobus. JR e bënë të qartë se nuk kishte asnjë lëndim dhe nuk pa asnjë shenjë të lëndimit në GM, që atëbotë ishte rreth 60 vjeç, dhe ishte në gjendje të ecë vetëm, pa ndihmën e askujt, të ngjitet në autobus dhe të zbres.

3.5 Me të arritur në Burgun e Lipjanit më 24 Maj 1999, të burgosurit u urdhëruan të zbresin nga autobusët. GM zbriti nga autobusi menjëherë pas JR. Me të zbritur nga autobusi, JR ishte në gjendje të sheh Gardianët e Burgut. Ai deklaroi se ata “na prisnin me shkopinj në dorë”. Përveç gardianëve të burgut, kishte paramilitarë dhe polici ushtarake. Ata ishin të armatosur me shkopinj. Gardianët, paramilitarët dhe policia ishin pozicionuar në dy rreshta me një ngushticë mes vete duke formuar një korridor. Ai korridor çonte prej autobusit deri tek dera nëpërmjet të cilës të burgosurit

² Procesverbal i Seancës Dëgjimore përballë prokurorit të PSRK-së, 24/05/2011, faqe 3

³ Procesverbal i Mundësisë Hetuese të Jashtëzakonshme 17 Tetor 2012, faqe 25

⁴ Procesverbal i Mundësisë Hetuese të Jashtëzakonshme 17 Tetor 2012, faqe 5-6

duhej shkuar për të hyrë në Pavilionin e Burgut. ZK ishte pjesë e këto dy radhëve. JR e përshkruan atë si në vijim: ‘ZK është njëri, fytyrën e të cilit kurrë nuk do ta harrojë. Ai mbante një shkop, sidoqoftë, më me rëndësi ishte një objekt që ai e kishte të lidhur në kyç të dorës. Dhe ishte shumë i zemëruar, ishte tërësisht i marrë’.⁵

3.6 Të burgosurit u detyruan të kalojnë nëpër këtë korridor të gardianëve një nga një. GM shkoi përpara JR, i cili ishte 5-10 metra prapa. Posa GM iu afrua ZK, K filloi ta rrahë duke përdorur një shkop, grushta dhe shqelma, të goditurat binin mbi gjithë trupin e tij, e në veçanti në shpinë dhe kokë. Të rrahurat zgjatën 4 deri në 5 minuta. Si rezultat i kësaj rrahjeje GM u rrah për toke. Me të rënë në tokë, GM nuk ishte në gjendje të ngritet përsëri. JR pa se ZK vazhdoi të shqelmonte GM pasi që kishte rënë në tokë. Në një çast, njëri nga gardianët bërtiti ‘mjaft K, njeriu vdiq’. Në një çast GM e shtynë gardianët anash me shqelma. Në këtë çast JR i dukej se GM ishte alivanosur. Dëshmia e JR nuk e bënë të qartë nëse ZK veproi vetëm në rrahjen e GM. JR deklaroi gjatë Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese si në vijim ‘unë e pashë ZK të rrihte GM, mbase kishte të tjetër që e rrihnin atë, sidoqoftë kur vështroja, e kisha kokën ulur dhe duart e lidhura mbrapa. Unë vetëm pashë ZK, por mbase kishte dhe të tjetër që e rrihnin atë’ kurse në seancën përballë prokurorit publik ai deklaroi se ‘vetëm ky njeri [ZK] e rrihte G dhe jam i sigurt për këtë’.

3.7 Pasi që GM kaloi dy rreshtat e gardianëve, radhën e kishte JR. Ai [JR] kishte mbetur 5 – 10 metra nga GM gjatë rrahjes së GM. Pas kësaj, ZK shikoi mbi JR dhe thirri ‘Tjetri!’. JR u afrua. Edhe pse me kokë ulur, bëri përpjekje të mbante shikimin në ZK. JR i kishte edhe duart e lidhura mbrapa. Megjithëse JR fillimisht deklaroi se i kishte duart e lidhura mbrapa, ai më vonë sqaroi se ajo çfarë mendonte ishte se e kishin urdhëruar të mbante duart mbrapa në shpinë, por nuk i kishte të lidhura.⁶ ZK ishte i armatosur me diç të lidhur në dorë. Megjithëse JR u godit për toke, arriti të ngritet në këmbë, duke besuar se do të ishte fatale po të mbetej shtrirë për toke. Posa u ngrit në këmbë, JR e kishte të qartë se një tjetër njeri iu bashkëngjit rrahjes, duke përdorur diçka si tytë të armës, grushta dhe shkopinj. E vlerësoi se tre deri në katër persona të tjerë ishin të përfshirë në rrahjen e tij. U rrah mbi tërë trupin dhe si rezultat pësoi mavijosje dhe dhimbje.

3.8 GM nuk e vendosën në dhomën e njëjtë në Pavilionin e burgut me JR. Prandaj JR nuk mësoi për vdekjen e G deri pas dy ditësh.

⁵ Procesverbal i Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese 17 tetor 2012, faqe 11

⁶ Procesverbal i Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese, faqe 36

3.9 Trupi gjykues vë në dukje se JR është sfiduar nga të dy, Prokurori⁷ dhe Mbrojtja⁸ lidhur me atë pse nuk i raportoi pretendimet e tij kundër ZK deri në vitin 2009. Trupi gjykues e konstaton se shpjegimet e tij lidhur me raportimin e vonë të çështjes tek autoritetet, me një fjalë se nuk kishte kuptim të raportohen çështjet tek autoritetet gjatë kohës së luftës dhe se pas luftës donte të sigurohej se e kishte gjetur ZK e saktë për të penguar mundësinë e arratisjes së tij, janë përgjigje bindëse dhe të besueshme, të cilat Trupi Gjykues i pranon. Prandaj në vijim Trupi Gjykues nuk e konsideron fakt të thjeshtë se një periudhë 10 vjet që ka kaluar në mes ngjarjes dhe paraqitjes se rastit e bënë tregimin e JR më pak të besueshëm.

3.10. Identifikimi:

3.10.1 Mundësia e Hetimeve të Jashtëzakonshme – JR ka dhënë përshkrimin e ZK si në vijim – 23 ose 24 vjeç, i gjendjes së mirë fizike, mjaft të aftë. Flokët ishin të shkurta.⁹ JR e konfirmoi se i Pandehuri ishte i njëjti ZK të cilin e përshkruante dhe i cili kishte rrahur GM dhe JR.¹⁰

3.10.2 Identifikimi fotografik – JR edhe një herë e konfirmoi identifikimi e tij fotografik në seancën e Mundësisë së Hetimeve të jashtëzakonshme.¹¹

3.10.3. Deklarata e dëshmitari dhënë PK-së më datë 10 Dhjetor 2009 – përshkruan rrahjet dhe një gardian duke i thënë njeriut duke i shkaktuar rrahjet ‘mjaft K, njeriu vdiq’. Po ashtu deklaroi se e njohu K, të cilin e njohte në fytyrë.

3.10.4. Deklarata e dëshmitarit dhënë Policisë së EULEX-it më 24 Shtator 2010 – përshkruan qëndrimin tij të parë në burg dhe ‘Z*****’ si gardian. E përshkruan K rreth 23 vjeç, rreth 185 cm të gjatë, sytë kafe, flokët të shkurtë ngjyrë kafe, vragë në anën e majtë të fytyrës (I pandehuri ka një vragë të tillë). E përshkruan rrahjen e GM më datë 24 Maj 1999 dhe përsëritë se një gardian kishte thënë ‘mjaft K, se po e mbyti njeriun’.

3.10.5. Deklarata e dëshmitarit e datës 10 janar 2011 – e përshkruan K rreth 23 vjeç, korpulent, rreth 185 cm të gjatë, me sytë kafe, flokë shumë të shkurtë me ngjyrë kafe, fytyrë të rrumbullakët, një vragë në anën e majtë të fytyrës, Nga fotografia, ai në mënyrë të saktë e identifikoi ZK me numër 2.

3.10.6. Procesverbal nga seanca dëgjimore e dëshmitarit tek prokurori më datë 24 Maj 2011 – në mënyrë të saktë identifikon fotografinë me numër 2 (fleta 1) dhe

⁷ Procesverbal i Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese, faqe 23

⁸ Procesverbal i Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese faqe 25-34

⁹ Procesverbal i Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese faqe 21

¹⁰ Procesverbal i Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese faqe 21

¹¹ Procesverbal i Mundësisë së Jashtëzakonshme Hetuese faqe 22 - 23

fotografinë me numër 7 (fleta 2) si ZK . Njih një fotografi të letërnjoftimit të siguruar nga prokurori më datë 29 Mars 2011 si ZK. Përshkruan ZK me një vragë në anën e majtë të fytyrës.

- 3.11. Ekziston një çështje e rëndësishme për Panelin në caktimin e peshës së besueshmërisë së përgjigjeve të dëshmitarëve të tjerë në pyetjen lidhur me emrin e të pandehurit dhe identifikimin. JR e pranon se pasi që kishte mësuar shtëpinë e ZK, kishte shkuar në fshatin e R. G. (një dëshmitar tjetër në këtë çështje) për të gjetur adresën e saktë të familjes së GM. Është e qartë se kjo do të përfshinte disa diskutime me RG lidhur me faktet dhe pretendimet në këtë çështje kundër ZK. Më pastaj, JR shkoi në shtëpinë e familjes së GM dhe përsëri foli me ata lidhur me faktet dhe pretendimet e kësaj çështjeje. Vërtetë është e qartë se në kohë të ndryshme të gjithë dëshmitarët faktik në këtë çështje kanë folur dhe ndarë kujtesën lidhur me ngjarjet dhe personin që ta pretendojnë se ka kryer veprat penale, duke përfshirë këtu përmendjen e emrit dhe përshkrimet e tij. Si pasojë në mënyrë të pashmangshme tani ekziston një kujtesë e përbashkët se sa e veçuar dhe e pavarur e identifikimit të kryesit të veprës. Kjo marrëveshje e fshehtë ishte e çiltër meqë nuk ishte përpjekje e qëllimshme për të ndikuar në njëri tjetrin, por sidoqoftë me këtë dobëson paanshmërinë e dëshmisë së tyre dhe dukshëm zbutë peshën që trupi gjykues mund vej mbi provat tjera të identifikimit nga dëshmitarët e mbetur.
- 3.12. Trupi gjykues dëgjoi dëshmitarët e tjerë në këtë çështje siç përshkruhet në paragrafin 1.6 më lartë. Nuk është e nevojshme të përshkruhet në detaje dëshmia e këtyre dëshmitarëve. Sa i përket fakteve lidhur me mënyrën si janë pranuar të burgosurit në burgun e Lipjanit në ditën përkatëse, si dhe lidhur me rrahjet e GM dhe JR, të gjithë dëshmitarët gjerësisht janë në përputhje me JR me përjashtim të atyre të cekur në paragrafin 3.14 më poshtë. Trupi gjykues është plotësisht i kënaqur se nuk kishte dallime të dukshme substanciale në tregimet e tyre që do të kishin dëmtuar besueshmërinë e JR.
- 3.13. Sidoqoftë, siç është vënë në dukje sipër, trupi gjykues ka trajtuar dëshminë e identifikimit që burojnë nga dëshmitarët e tjerë me kujdes të madh. Është e qartë se p[ara se të raportonte JR pretendimet e tij kundër ZK në polici, ka ekzistuar një diskutim i konsiderueshëm në mes JR dhe dëshmitarëve të tjerë sa i përket identifikimit të ZK.¹² trupi gjykues nuk e konsideron se kjo ishte përpjekje e qëllimshme për të ndikuar në dëshmitarët, por nuk mund të përjashtojë mundësinë se një diskutim i tillë në mënyrë të padjallëzuar ka ndikuar dhe prejudikuar kujtesën e dëshmitarëve të tjerë sa i përket identitetit të saktë të personit përgjegjës për rrahjen e GM dhe të JR. Po ashtu është vënë në dukje se si disa dëshmitarë në deklaratat e mëvonshme si dhe në gjykim kanë përmendur ZK por nuk ishin në gjendje të bëjnë këtë

¹² Shih për shembull dëshminë e F. M. në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të 1 Nëntorit 20122 dhe të H. M., në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 2 Dhjetor 2011.

në deklaratat e tyre të mëhershme policisë dhe prokurorëve. Përfundimisht ka pasur mospërputhshmëri të konsiderueshme në përshkrimet e dhëna nga dëshmitarët e tjerë, duke përfshirë së paku një që përshkruan sulmuesin si person të moshës 40 vjeçe. Qartë, ky nuk mund të jetë ZK nëse është e saktë. Prandaj trupi gjykues konkludon se dëshmitarët e tjerë vërtetojnë fuqishëm tregimin e JR sa i përket asaj çfarë ka ndodhur, por nuk jep dëshmi, të cilës peshë e rëndë mund t'i bashkëngjitet sa i përket identifikimit të personit përgjegjës.

- 3.14. Përjashtim bënë dëshmia e I. P. Ky dëshmitar deklaroi gjatë deklarimit të procedurës paraprake se ai nuk do të njihnte personin përgjegjës për rrahje. Ai nuk ka bërë identifikim fotografik. Kështu, për aq sa ka pasur marrëveshje të fshehtë në mes të dëshmitarëve lidhur me identitetin e ZK, kjo nuk vlen për I.P. sepse ai mbeti i qartë që nga fillimi deri në fund se ai nuk do të ishte në gjendje të njeh personin përgjegjës. Sidoqoftë, gjatë dëshmisë së tij ai tha se gjatë rrahjeve, kishte dëgjuar gardianët t'i kenë thënë personit kryesor përgjegjës për rrahje 'godite, goditë Z****'. Z**** është nofka e ZK. Do të ishte coincidence e pabesueshme nëse personi përgjegjës për rrahje ndodhë të ketë nofkën e njëjtë me të pandehurin. Trupi gjykues është i mendimit se nuk ka gjasa të jetë coincidence dhe vërtetohet fuqishëm saktësia e JR që identifikon ZK si kryes të veprës.
- 3.15. Mbrojtja ka thirrë disa dëshmitarë. Esencialisht, ata pohuan se asgjë me rëndësi nuk ka ndodhur dhe se aq nëse ka ndodhur, ZK nuk ka pasur asnjë rol në të. Trupi gjykues ka shqyrtuar me kujdes këtë dëshmi dhe e ka hedhur poshtë si të pavërtetë dhe të pabesueshme. Ngjarjet e 24 Majit 1999 në burgun e Lipjanit thjeshtë kanë ndodhur. M. D. punonte si zyrtar shëndetësor përgjegjës për përkujdesjen e njerëzve të ndaluar në burgun e Lipjanit. Atij i kujtohej se një numër i madh i të burgosurve arrinin në burgun e Lipjanit më 24 Maj 1999, dhe se disa ishin të lënduar për shkak të ngjarjeve në burgun e Dubravës. Sidoqoftë, M. D., pozitivisht e mohoi se ndonjë i burgosur ka vdekur në burgun e Lipjanit dhe nuk i kujtohet vdekja e GM në burgun e Lipjanit. Në këtë drejtim trupi gjykues konkludon se kujtesa e M. D. mbi ngjarjet është e pabesueshme dhe nuk mund të ndihmojë në njërën ose mënyrë tjetër mbi çështjet primare të rrahjes së GM dhe JR.
- 3.16. S.M. ishte gardian në kohën përkatëse. Ai njhte ZK por nuk ishte në ndërrimin e njëjtë sikurse ai. Atij i kujtohet ardhja e të burgosurve më 24 Maj 1999 dhe se disa prej tyre kishin plagë nga ngjarjet në Dubravë. Ai e mohoi se ishte i pranishëm gjatë gjithë kohës që të burgosurit pranoheshin në Lipjan, por e mohoi se kishte parë ZK të ishte i pranishëm atë kohë dhe e mohoi se është përdorur dhuna ndaj të burgosurve. Trupi gjykues e konsideron dëshminë e M. si bishtnues, të pabesueshëm dhe të pasaktë. Është e qartë se është përdorur kundër të burgosurve dhuna, e cila shkaktoi vdekjen e GM. Mund të jetë që ose zotëri M. nuk e ka parë sepse nuk ishte i pranishëm gjatë gjithë kohës kur bëhej pranimi i të burgosurve, ose për shkak se nuk

ishite i sinqertë. Sidoqoftë, pa besueshmëria e tij i lejon trupit gjykues të hedhë poshtë pohimet e tij se ZK nuk ishte i pranishëm. M. M. ishte i pranishëm në burgun e Lipjanit ditën në fjalë dhe punonte si shef i ndërrimit. Atij i kujtohet ardhja e të burgosurve. Ai nuk ishte i sigurt sa i përket vendit të punës së ZK ditën në fjalë, por mendon se K ishte duke punuar në Pavilionin e katërt. Zotëri M. deklaroi se gjatë gjithë kohës në fjalë ishte në detyrë në 'zyrën e regjistrimit'. Zotëri M. nuk i kujtohet GM ose dikush që vdiste në burg në kohën në fjalë. Zotëri M. nuk ishte i pranishëm në lokacionin përkatës në oborrin e burgut gjatë çasteve të rrahjeve të pretenduara. Prandaj, ai nuk është në gjendje t'i ndihmojë gjykatës për të marrë vendim mbi çështjet kyçe. Dëshmia e tij nuk ndihmon. SR dha dëshmi dhe deklaroi se punoi me Z. K. në ditën në fjalë në Pavilionin 4. S. R. deklaroi se dëgjoi ardhjen e makinave në burg ditën në fjalë dhe doli së bashku me ZK të shikojë se çfarë po ndodhte. Zotëri R. e mohoi se ai ose Z kishin ndonjë rol në pranimin e të burgosurve dhe se kurrë nuk shkuan më larg se porta e Pavilionit 4. Aq sa S. R. kërkoi të mbështesë dëshminë e ZK, ekzistonte ndryshim material në mes asaj çfarë tha ai dhe çfarë tha ZK, përfshirë se zotëri R. deklaroi se as ai e as ZK dolën jashtë portës së Pavilionit 4, kurse K deklaroi se ata dolën jashtë portës. Në këto rrethanat, trupi gjykues konkludon se zotëri R. nuk ishte dëshmitar i besueshëm ose i sinqertë sa i përket ngjarjeve në Lipjan më 24 Maj 1999.

3.17. Kur shtëpia e ZK u bastis më 7 Prill 2011, në fshatin D*****, një revole e tipit Zastava TT e kalibrit 7.62 mm me numër serik 1878 është gjetur në pronësi të ZK së bashku me dy karikatorë dhe 37 plumba. Të gjitha këto ishin funksionale, por ZK nuk posedonte leje valide për armë.

3.18. Duke vepruar kështu, i Akuzuari ZK ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

3.19.

4. Përgjegjësia Penale e ZK

4.1. Duke pasur parasysh faktet dhe vlerësimi i dëshmive të përshkruara në paragrafin 3 më lartë, trupi Gjykues është i kënaqur me standarde penale të dëshmive se i Pandehuri ZK ka marrë pjesë dhe është penalisht përgjegjës për kryerjen e sulmit grupor, duke përdorur shkopinj, grushta dhe armë mbi GM, i cili më pas vdiq nga plagët e pësuar gjatë sulmit, si dhe mbi JR.

4.2. Prandaj Trupi Gjykues është i kënaqur se ZK është fajtor sa i përket Pikës Një dhe Pikës Dy të aktakuzës.

4.3. Sa i përket Pikës Tre, gjetja e armëve funksionale dhe plumbave që janë marrë së bashku me mungesën e lejes valide, si dhe me pranimin e fajësisë së ZK sa i përket akuzës që e përcakton përgjegjësinë penale të tij lidhur me Pikën Tre

5. Dënimi

5.1. Trupi Gjykoës ka marrë parasysh seriozitetin e sjelljes me pasojë vdekjen e GM dhe shkeljen serioze të besimit që rezulton me një gardian që abuzon pushtetin dhe autoritetin duke shkaktuar dhunë të paligjshme mbi të burgosurit, të cilët ishin të paarmatosur dhe në pamundësi të mbrojnë veten. Trupi gjykoës po ashtu merr parasysh moshën e GM në kohën e sulmit.

5.2. Trupi gjykoës ka marrë parasysh si rrethana lehtësuese si në vijim: kalimin e kohës, njeri familjar, ishte i ri në atë kohë, nuk ishte as organizator e as lider i incidentit.

6. Shpenzimet

6.1. Trupi gjykoës konkludon se i Pandehuri duhet paguar shpenzimet në shumë prej 144,80 Euro.

Gjyqtari Kryesues
Jonathan Welford Carroll

Anëtare e Trupit Gjykoës
Mejreme Memaj

Anëtar i Trupit Gjykoës
Andrew Hatton

Procesmbajtës
Robert Abercrombie

Këshilla Juridike:

Palët kanë të drejtë të ankohen kundër këtij aktgjykimi brenda 15 ditësh nga dita kur kopja e aktgjykimit dorëzohet në pajtim me Nenin 398 Paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Paraprake të Kosovës (KPPK-së) në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Prishtinës.